



Raporti i 6-mujorit
të parë të vitit 2022

Kompania Lufra 2022



Një përmbledhje nga drejtuesit e kompanisë



"Të dashur miq,
Viti 2022 nisi me projekte të reja dhe me shumë dëshirë e vullnet për të rritur standartet që kemi vendosur në industrinë e përpunimit të qumështit. Në Janar, u hap dega e kompanisë "Lufra" në Prishtinë dhe nga ai moment Shqiptarët e Kosovës kanë mundur të shijojnë produktet autentike aq të dashura nga ta. Kriza globale ndikoi jo pak në industrinë tonë, me rritjen e çmimit të energjisë, naftës, lëndës së parë nga fermeret apo edhe paketimeve plastike dhe kartoni. Megjithatë ne jemi të vendosur për ta cuar vizionin tonë përpara. Fabrika në Lushnje zgjeroi kapacitetin e prodhimit dhe u pajis me një tjetër laborator modern i cili shërben vetëm për analizat e fazës së pranimit të qumështit. Mirëpritëm vizitorë të panumërt duke nisur nga kuriozët e vegjël të shkollave që vizituan edhe fermerët tanë, grupe studentësh me të cilët shkëmbyem ide të vyera por edhe ekspertë vendas e të huaj të cilët vlerësuan teknologjinë e prodhimit dhe qasjen tonë ndaj cilësisë. Një tjetër arritje është regjistrimi i markës Lufra si Trademark në territorin e Bashkimit European dhe Serbi" – Z. Luis Ndreka, CEO

Përgjatë 6-mujorit të parë të vitit 2022, shumë punonjës të rinj ju bashkuan familjes së madhe "Lufra" po ashtu shumë studentë në programin tonë të internshipit.


Më shumë trajnime dhe më shumë politika të brendshme për motivimin e punonjësve dhanë një impakt të shpejtë tek punonjësit tanë.


Konsumatorët në 2022

Për paktimet Tetrapak por jo vetëm, ne sollëm në designe të reja, më të qarta, me më shumë specifikime mbi vlerat ushqimore dhe mënyrën e përdorimit, të cilat u mirëpritën nga konsumatorët. Muaji Maj dhe Qershor e gjejnë kompaninë tonë në fluks përgatitor për sezonin e verës, për të përballuar më së miri kërkesat e konsumatorëve tanë në Shqipëri, Kosovë dhe SHBA.

Fermerët tanë

Bindja jonë është se asgjë nuk arrihet vetëm. Kriza globale ka ndikuar edhe fermerët tanë, kryesisht në rritjen e çmimeve për ushqimet e bagëtive, naftën e nevojshme për makineritë e përpunimit të tokës. Për fermerët tanë u vendos rritja e çmimit të lëndës së parë, qumështit të freskët, në bazë të një strukture të mirëmenduar e cila nxit përmirësimin e cilësisë dhe rrit produktivitetin njëkohësisht.





Teknologjia në shërbim të cilësisë

Automatizimi është një ndër faktorët kyç që ndikon në rritjen e standarteve. Ne vijojmë të vendosim standartet më të larta në industrinë ku operojmë. Përmes sistemit tonë automatik ne u dërgojmë fermerëve tanë çdo ditë rezultatet e analizave të qumështit që kemi grumbulluar nga ta.

Pasi qumështi i freskët vjen nga ferma për në fabrikë, menjëherë analizohet në laboratorin e pranimit të qumështit. Rezultati i analizave shkon automatikisht nga sistemi me SMS në telefonin e fermerit. Nëse vlerat e analizave nuk janë sipas standarteve, qumështi asgjësohet.

Kjo teknologji e implementuar përveçse nxit fermerët të përmirësojnë cilësinë e lëndës së parë, ndikon me tej në mbajtjen e regjistrit dhe historikut të analizave për çdo fermer dhe i motivon ata në punën e tyre!

Lufra rregjistrohet si Trademark në territorin e Bashkimit Europian!

Në bazë të artikullit 189(2) EUTMR dhe artikullit 79(2) EUTMDR, marka "Lufra" është rregjistruar dhe njihet si markë e mbrojtur në të gjithë territorin e Bashkimit Europian. Një tjetër hap që na afron drejt vizionit tonë. Shpresojmë që në një të ardhme të afërt produktet Lufra të gjenden edhe në frigoriferët e marketeve në shtetet e BE.

Lufra themelon degën e saj në Kosovë!

Jemi shumë të lumtur që pas një pune të madhe të skuadrës tonë, mundëm të realizonim një ëndërr. Tashmë vëllezërit tanë në Kosovë, mund t'i gjejnë produktet Lufra në marketet më të afërta.



Ndryshime dhe përparimet në fabrikën Lufra gjatë 6 muajve të parë të vitit 2022



Fabrika në Lushnje zgjeroi kapacitetin e prodhimit dhe u pajis me një tjetër laborator të madh i cili shërben vetëm për analizat e fazës së pranimit të qumështit. Në këtë laborator kryhen analizat organoleptike, fizike, të alkoolit, aflatoksinës etj. të cilat vlerësojnë parametrat e qumështit të grumbulluar nga fermerët tanë përpara se të kalohet në proceset e prodhimit. Tashmë pranimi i qumështit është i organizuar në një seksion të veçantë të fabrikës, ku ka punonjës të specializuar dhe trajnuar vetëm për këtë proces por edhe makineri të dedikuara. Kjo ka rritur efikasitetin e punës dhe nivelin e organizimit të prodhimit.

Grumbullohet
+60 ton
qumësht çdo ditë

+40 kode
produktesh
në treg

Lufra punon ne kapacitete optimale edhe për prodhimin e shisheve me plastikë ushqimore në fabrikën e saj, nëpërmjet makinerinë Kronen të fjalës së fundit, duke garantuar një tjetër hallkë sigurie për materialet e përdorura në produktet finale.

Parku i paneleve fotovoltaike



Lufra ka implementuar impiantin e paneleve fotovoltaike prej 2 muajsh dhe mbulon thuhetse gjysmën e energjisë që konsumohet në fabrikën në Lushnje.



Zhvillimet në Departamentin HR

Lufra mori pjesë në Panairin e Karrierës së Fakultetit të Ekonomisë Tiranë, nga ku kishte një interes shumë të madh për pozicionet vakante në rolet administrative dhe manaxheriale. Po ashtu morëm pjesë në Panairin e Punës së Fakultetit të Gjuhëve të huaja dhe Filologjisë, Universitetin Qirazi dhe Universitetin Europian të Tiranës.

Këto 6 muaj punonjësit tanë morën pjesë në **294 orë trajnimi** të zhvilluara nga ekspertë të fushës dhe **mbi 5 programe trajnuese**.

Nga këto trajnime mund të përmendim:

- Trajnimin për Higjenën nga AlbAcademy
- Trajnimin në punë në sektorin e mikpritjes dhe agroindustrisë nga GIZ Albania
- Trajnimin për Organizatat Agile
- Trajnimin mbi Menaxhimin e Projekteve nga EPPC
- Trajnimin mbi Direktivat dhe Protokollat e Design nga Tetrapak e shumë të tjera



Lufra vazhdon bashkëpunimin e suksesshëm me UNFPA Albania dhe së fundmi morëm pjesë në prezantimin e studimit kombëtar të projektit "Më shumë Zgjedhje: Politikat Familjare të Përgjegjshme Gjinore për Sektorin Privat në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi", përgatitur nga IDRA Research & Consulting, nga ky linden shumë diskutime dhe pikënisje për përmirësimin dhe adaptimin e politikave të reja në ambientin e punës.

Politikat e motivimit dhe zhvillimit të stafit

Çdo muaj në kompaninë Lufra zgjidhen 3 punonjësit më të mirë të muajit në secilin departament, bazuar në kriteret e mirëpërcaktuara. Komunikimi me eprorët dhe qartësimi i përgjegjësisë të çdo roli është prioritet ndaj në Lufra është krijuar një ambient miqësor ku çdokush mund të thotë mendimin e tij lirisht dhe të gjenerojë ide.



Progresi në Programin e Përgjegjësisë Sociale



Në ditën e mësuesit dhuruam libra për bibliotekën e re të Gjimnazit "Pali Dani" në Gorre, Lushnje!



Morëm pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë, Teknologjive, Ushqimit dhe Përpunimit në Lushnje, ku dhuruam produkte për konsumatorët tanë besnikë por edhe vumë në dispozicion të konsumatorëve produkte të reja për t'i degustuar. Po ashtu morëm pjesë në Panairin e produkteve vendase në Sheshin "Nënë Tereza".

Gjatë këtyre 6 muajve mirëpritëm studentë dhe vizitorë nga e gjithë Shqipëria për të parë nga afër proceset e prodhimit, një hallkë shumë e rëndësishme e programit tonë të transparencës!



Lufra dhuroi çmimin "Ferma e Vitit 2021"

Ferma e Vitit 2021 u zgjodh ajo e Zonjës Mihane e cila sëbashku me familjarët e saj punuan për të treguar përkushtim, rritje të cilësisë, rezultate të shkëlqyeshme në analizat e qumështit dhe perspektivë për zhvillimin e mëtejshëm të fermës!

Aktiviteti i veterinerëve në ferma zgjerohet



Shtohet numri i veterinerëve të cilët janë në dispozicion të fermerëve tanë për çdo problematikë të bagëtive apo për të dhënë këshillat e tyre për rritjen e kushteve në stalla.

LUFRA vijon bashkëpunimin me Tetra Pak dhe Tetra Laval Food for Development për të krijuar 'Dairy Hubs' në Shqipëri.

Nisma fokusohet në zhvillimin e një infrastrukture formale të grumbullimit të qumështit dhe ofrimin e asistencës teknike për fermerët e vegjël të qumështit. Objektivi është që trajnimi i ofruar për fermerët e vegjël t'i ndihmojë ata të rrisin të ardhurat e tyre.

I bashkohemi nismës kundër shpërdorimit të ushqimit!

Për të eliminuar shpërdorimin e produktit nga ana e konsumatorëve, "Lufra" ka sjellë në treg edhe formatin IL të qumështit. Lufra është e angazhuar nëpërmjet programit të edukimit të inkurajojë konsumatorët të përdorin produktet në mënyrën më të përgjegjshme të mundshme, duke mos shpërdoruar apo hedhur ushqimin. Ne jemi koshientë për sfidat e shumë familjeve për të siguruar ushqimin e përditshëm.

Produktet tona ofrojnë një game të ndryshme produktesh si edhe sasish, duke i dhënë mundësi konsumatorit të konsumojë vetëm produktin që ka nevojë dhe duke mos shpërdoruar ushqimin.

Skuadra Lufra dhe e ardhmja!



Në fund të fundit jemi një skuadër e madhe që adhuron natyrën dhe gjithmonë gjejmë pak kohë për të eksploruar bukuritë e Shqipërisë tonë.

Në treg prezantohet marka më e re "TIDO"!!!

TiDo



TIDO është marka më e re e kompanisë Lufra e cila sjell në treg kos me shije në një ambalazh unik dhe një shije shumë të veçantë. Kosi i ndarë ku nga njëra anë është kosi dhe nga ana tjetër reçelrat, mjalti apo drithërat e shijshëm i japin mundësinë konsumatorit të krijojë përzierjen që dëshiron në sasinë që dëshiron!

SUPER TRANSPARENTË = SUPER CILËSI = SUPER SHIJE

